V E N D I M
Nr.247, datë 4.4.1998

PËR NEGOCIMIN E NDRYSHIMIT TË NDËRMJETËSVE FINANCIARË NË MARRËVESHJET EKZISTUESE TË KREDIVE DHE NDIHMAVE TË HUAJA

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autorizohet Ministria e Financave të negociojë në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, me donatorët/kreditorët e huaj për ndryshimin e ndërmjetësve financiarë brenda vendit, të përcaktuar në marrëveshjet ekzistuese të ndihma/kredive për mbështetjen e sektorit privat. Ndërmjetësit e rinj do të jenë bankat tregtare me kapital tërësisht ose pjesërisht shtetëror, bankat tregtare private, vendase ose të huaja dhe institucionet e tjera financiare, private a publike, të licencuara për dhënie kredie ose pjesëmarrje me fondet e veta në kapitalin e shoqërive tregtare.

2. Zgjedhja e ndërmjetësve financiarë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi bëhet mbi bazën e konkurrimit mes atyre që përmbushin normat dhe standardet e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë për dhënie huaje. Për këtë Ministria e Financave kërkon nga Banka e Shqipërisë një konfirmim me shkrim për vlerësimin dhe klasifikimin e ndërmjetësve financiarë të licencuar e mbikëqyrur prej saj, si dhe një opinion për ndërmjetësit që investojnë ose kreditojnë në sektorin privat kapitalet e veta.

3. Të gjitha huatë dhe ndihmat e marra nga qeveria shqiptare për mbështetjen me kredi të sektorit privat brenda vendit, në bazë të marrëveshjes ekzistuese, do të konsiderohen ndihma dhe kredi të marra nga qeveria shqiptare. Në të gjitha rastet Ministria e Financave, në emër të qeverisë shqiptare lidh marrëveshje huaje me ndërmjetësit financiarë të zgjedhur prej saj dhe të pranuar nga donatorët/kreditorët. Kushtet e nënhuasë janë në çdo rast ato të përcaktuara në marrëveshjet e ndihmave/kredive të lidhura me donatorët, kurse risku i dhënies së huasë brenda vendit ndahet ndërmjet qeverisë dhe ndërmjetësve financiarë në varësi nga lloji i riskut.

4. Nënhuatë e dhëna deri tani nga ndërmjetësit financiarë, të përcaktuara në marrëveshjet ekzistuese të ndihma/kredive, të transferohen te ndërmjetësit e rinj, të cilët marrin përsipër vazhdimin e programeve. Nëse ndërmjetësit e rinj nuk marrin përsipër portofolin e huave të dhëna më parë, atëherë transferimi tek ato i pjesës së fondeve të papërdorura/padisbursuara do të bëhet me kushte tregtare.

5. Ministria e Financave, në bashkëpunim me donatorët/kreditorët e huaj dhe me ministritë/institucionet e tjera të vendit, deri në fund të muajit prill të vitit 1998, të përfundojë amendamentet e marrëveshjes ekzituese të ndihma/kredive lidhur me ndryshimin e ndërmjetësve financiarë dhe të marrëdhënieve të qeverisë shqiptare si huamarrëse me huadhënësit e huaj dhe ndërmjetësit financiarë brenda vendit.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano